



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 766/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Safa - Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Jetlir Zyberaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.766/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar Jetlir Zyberaj , kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2007A/05R, 0604C/05D, 0401D/01R, 2501D/10D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.766/2021 nga Jetlir Zyberaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimet 2007A/05R, 0604C/05D, 0401D/01R, 2501D/10D., dhe kërkon rinumërimin sa i përket këtij vendvotimi. Apelit i ka bashkangjitur formular ne të cilat pretendon se është bërë parregullsia.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Jetlir Zyberaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkon rinumërim të votave në vendvotimet 2007A/05R, 0604C/05D, 0401D/01R, 2501D/10D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.766/2021, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Jetlir Zyberaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, më të cilin apel kërkon rinumërim të votave për kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja

Demokratike e Kosovës për vendvotimin vendvotimet 2007A/05R, 0604C/05D, 0401D/01R, 2501D/10D, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime sepse pritet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritjet e bera nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Jetlir Zyberaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 766/2021 më datën 06.03.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.